



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Komisioni për Shërbime Publike,
Administratë Lokale dhe Media
Mbledhja nr. 5
Prishtinë, më 21 prill 2008, ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës, salla N-10

Procesverbal

i mbledhjes së Komisionit për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media

Në mbledhje morën pjesë: Esat Brajshori, Fehmi Mujota, Shpresa Murati, Gani Buqinca,
Hajdin Abazi, Melihate Tërmkollli, Anita Morina, Rasim Selmanaj,
Synavere Rysha, Radmila Vujović dhe Ali Lajçi.

Nga Sekretaria e Kuvendit: Shpresa Haxhijaj - në cilësinë e administratores, Fatime Qorri -
zyrtare ligjore dhe Mirjeta Heta - nëpunëse administrative.

Mbledhjen e udhëhoqi Esat Brajshori - kryetar i Komisionit, me këtë

REND DITE

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar
2. Shqyrtimi i listës së KPM-së të 08. 06. 2007 për emërimin e anëtarëve të Bordit të RTK-së.
3. Shqyrtimi i Projektligjit për vula në institucionet e Republikës së Kosovës nr. L – 054
4. Të ndryshme

Rendi i ditës u miratua pa plotësime

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar.

Procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i listës së KPM-së të 08. 06. 2007 për emërimin e anëtarëve të Bordit të RTK-së.

Esat Brajshori – I njoftoj anëtarët e Komisionit se lista e propozuar nga KPM-ja për emërimin e anëtarëve të Bordit të RTK-së ka ardhur në Kuvendin e Kosovës më 08. 06. 2007,

pra në mandatin e kaluar. Kuvendi nuk ka proceduar me këtë listë për shkak të zgjedhjeve, prandaj kjo listë është bartur në këtë mandat. Komisioni në këtë mbledhje do të vendosë se si do të procedohet me këtë listë për zgjedhjen e anëtarëve të Bordit të RTK-së. Hap diskutimin lidhur me këtë çështje.

Fehmi Mujota - Tha se çështja e emërimit të Bordit të RTK-së ka mbetur e papërfunduar nga mandati i kaluar. Në bazë të Ligjit për RTK-në, nenet 23.1 dhe 23.2 a, b dhe c, KPM-ja sjell një listë në Kuvend me 18 anëtarë të propozuar. Në pikën d) të nenit 23.2 Kuvendi e themelon një komision ad hoc për shqyrtimin e listës së propozuar nga KPM ja, por komisioni i formuar ad hoc nga Kuvendi në mandatin e kaluar nuk ka mund ta përfundojë punën e vet për shkak të zgjedhjeve në Kosovë. Tani e kemi të njëjtën listë, por rrethanat kanë ndryshuar dhe Kryesisë së Kuvendit i mbetet të procedojë më tutje me listën ose ta formojë komisionin ad hoc ose ta kthejë listën në KPM. Ne si Komision e kryejmë punën nëse e përcjellim këtë çështje deri në Kryesinë e Kuvendit .

Melihate Tërmkollli - Tha se kjo çështje është bart nga mandati i kaluar, por kjo listë nuk është dashur të na vijë në këtë mënyrë vetëm me përkatësi kombëtare të këtyre emrave të përfshirë në listë, por është dashur që së paku ta ketë edhe përgatitjen profesionale. Këshilli i Pavarur i Mediave kur e ka bërë këtë propozim e ka shkelur ligjin në pikën që thuhet se kandidatët duhet të jenë të paanshëm politikisht, kurse në këtë listë disa të propozuar janë shumë aktivë në jetën politike si Dukagjin Gorani, Shkelzen Maliqi dhe shumë të tjerë. Mendoj se është shkelur ligji dhe kjo listë duhet t'i kthehet KPM-së të bëjë propozime të reja në harmoni me ligjin.

Fehmi Mujota - Tha se çështja e përkatësisë etnike dhe profesionale është e rregulluar me ligj, pra ne nuk kemi pse të merremi me të. Pozicioni i këtyre njerëzve të propozuar ka ndryshuar, por puna jonë është ta çojmë çështjen në Kryesinë e Kuvendit dhe ajo pastaj të marrë vendim në bazë të ligjit.

Melihate Tërmkollli - Tha se ligji nuk thotë se Komisionit duhet t'i vijë një listë me të dhëna vetëm për përkatësinë kombëtare, por duhet t'i silltet lista e plotë me të gjitha të dhënat për këta persona.

Esat Brajshori - Tha se ekzistojnë biografite e të gjithë këtyre personave dhe ndoshta do të duhej t'u shpërndaheshin. Pajtohem se listës i mungon pjesa thelbësore, përgatitja profesionale, por në lidhje me këtë, tani si Komision, a do të kërkojmë t'i kemi biografite e këtyre njerëzve të propozuar apo jemi dakord që duke e ditur se ekzistojnë biografite e tyre, ta marrim një qëndrim për procedim të mëtejshëm në Kryesinë e Kuvendit?

Gani Buqinca - Tha se duhet ta miratojmë në parim këtë listë dhe t'ia lëmë në kompetencë Kryesisë së Kuvendit ta shqyrtojë mundësinë se disa kandidatë nga kjo listë e kanë humbur të drejtën të jenë të propozuar, meqë janë të përfaqësuar në parti politike. Sa i përket përkatësisë nacionale ligji na obligon që Bordi i RTK-së të jetë multi-etnik. Ta përcjellim listën në Kryesinë e Kuvendit që sipas kompetencës së tij të marrë vendim konform ligjit.

Hajdin Abazi - Tha se na mungon biografia e këtyre personave dhe ne nuk mund të votojmë për këtë listë pa biografinë e tyre.

Esat Brajshori - Sqaroi se Komisioni nuk do të votojë për këtë listë. Komisioni e ka për detyrë t'i rekomandojë Kryesisë ta themelojë komisionin ad hoc dhe pastaj komisioni ad hoc do të kërkojë nga KPM-ja të propozojë listë të re me emra që nuk kanë konflikt të interesit.

Hajdin Abazi - Tha se propozon t'ia sugjerojmë Kryesisë që për shkak të ndryshimeve që kanë ndodhur të kërkojë nga KPM-ja ta procedojë një listë të re.

Synavere Rysha - Tha se sipas Ligjit për RTK-në, nenin 23.2 nën c), thuhet se Këshilli i KPM-së do t'i sjellë nga dy kandidatë të propozuar për secilën pozitë, pra për 9 vende të propozohen 18 kandidatë. Sipas saj disa nga kandidatët do të eliminohen, për shkak të përfshirjes në politikë, pra po eliminohet konkurrenca e mirëfilltë, ku një kandidat do të zgjidhet, një do të eliminohet. Mendoj se nëse votojmë në këtë mënyrë, e shkelim ligjin.

Esat Brojshori - Tha se ne vetëm i rekomandojmë Kryesisë se në bazë të të dhënave që i kemi për këtë çështje, të vendosë t'i kërkojë KPM-së të hapë konkurs të ri në lidhje me Bordin e RTK-së ose ta plotësojë këtë listë me emra të rinj që nuk kanë konflikt të interesit.

Synavere Rysha - Propozoi që Komisioni të mos e dërgojë listën në Kryesi, por si Komision ta kthejë listën e propozuar në KPM.

Esat Brajshori - Tha se sipas ligjit Komisioni ynë nuk vendos për këtë çështje, ai vetëm rekomandon dhe propozon.

Fehmi Mujota - Tha se pavarësisht nga procedurat, ne nuk jemi, si Komision, që vendosim se kush do të shkojë e kush jo. Kjo është kompetencë e komisionit ad hoc që i vlerëson profesionalizmin dhe çështjet e tjera dhe ia rekomandon Kuvendit emrat e kandidatëve.

Synavere Rysha – Tha, që në fillim, ne duhet të rekomandojmë që të kthehet lista në KPM dhe t'i shkurtojmë procedurat.

Rasim Selmanaj - Tha se si Komision nuk mundemi as të rekomandojmë, as të diskutojmë përderisa nuk kemi asnjë të dhënë lidhur me këtë listë. Së pari duhet t'i kemi të dhënat e pastaj të rekomandojmë. Lista duhet të kthehet në KPM dhe të na e bien një listë me të dhëna të plota.

Radmilla Vojović - Tha se sipas ligjit që e ka miratuar Kuvendi, shumica e kandidatëve të propozuar nuk i plotësojnë kushtet, prandaj duhet të marrim vendim që këtë listë ta përcjellim në një bord profesional që do të merret me këtë çështje.

Ali Lajçi – Tha: As e miratojmë, as e hedhim këtë listë, por kërkojmë që të na e bien atë me një procedurë të re, me propozime të reja, të shoqëruara edhe me biografi dhe me të dhëna profesionale për këta persona. Ne nuk mund të marrim vendim, sepse ka kaluar një kohë dhe kanë ndërruar rrethanat dhe për shkak të kohës kjo listë ka rënë.

Esat Brajshori - Tha se sipas ligjit Komisioni mund të bëjë vetëm referenca, propozime, por nuk mund të vendosë. Komisioni mund të kërkojë të dhëna për këta persona, por prapë nuk mund të vendosë. Kryesia do të vendosë të kërkojë nga KPM-ja listë të re, emra të rinj ose ta procedojë këtë listë të njëjtë dhe të formojë komisionin ad hoc. Pastaj komisioni ad hoc do t'ia propozojë Kuvendit anëtarët e Bordit.

Melihate Tërmkollli - Tha se kjo listë na ka ardhur jo e plotë dhe gjërat nuk duhet të shkojnë kështu. Anëtarët e Bordit të RTK-së nuk duhet të jenë njerëz të politikës. Deri tani Bordi i RTK-së ka qenë shumë i politizuar dhe në shërbim të një partie pra të PDK së.

Gani Buqinca - Tha se ka dy propozime: Njëri është t'ia rekomandojmë Kryesisë që t'ia kthejë KPM-së listën për të shpallur konkurs të ri dhe tjetri t'ia rekomandojmë Kryesisë ta rishqyrtojë këtë listë dhe t'i heqin nga lista kandidatët që nuk mund të jenë anëtarë të Bordit të RTK -së. Të votojmë për këto dy propozime.

Shpresa Murati - Tha se një debat i këtillë nuk na çon askund. Ne mund t'i drejtohem Kryesisë me kërkesë për riprocedim, por Komisioni nuk ka të drejtë drejtpërsëdrejti t'i drejtohet KPM-së, pra duhet të respektohet procedura.

Fehmi Mujota - Tha se ne do të jemi vetëm si iniciues dhe përsheptues të kësaj çështjeje, ndërsa kompetencat janë të KPM-së dhe të Kryesisë së Kuvendit. Të mos merremi shumë me këtë çështje.

Melihate Tërmkollli - Tha se kjo listë është dashur të shkojë drejtpërsëdrejti në Kryesi. Komisioni të mos marrë asnjë përgjegjësi për të. Përndryshe kjo listë duhet t'i kthehet KPM-së.

Esat Brajshori - Tha se jemi përgjegjës si Komision që e mbulon fushën e mediave për ta parë këtë çështje, pavarësisht nga forca që kemi për të vendosur për të, sepse ligji nuk na ka dhënë më shumë hapësirë. A jeni të mendimit që t'ia propozojmë Kryesisë së Kuvendit rishikimin e listës për Bordin e RTK-së, për të cilën Komisioni mendon se ka konflikt të interesit dhe sipas ligjit në marrëveshje me KPM-në të rishpallë konkurs për kandidatë të Bordit të RTK-së apo të vendosë si të procedojë me këtë çështje?

Komisioni me 9 (nëntë) vota për dhe 2 (dy) kundër votoi për rekomandimin e propozuar:

Komisioni për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media i rekomandon Kryesisë së Kuvendit që listën e propozuar nga komisioni ad hoc i KPM-së, për emërimin e anëtarëve të Bordit të RTK-së, ta kthejë në KPM për riprocedim me anëtarë të rinj, për shkak se disa nga anëtarët e propozuar në këtë listë janë në kundërshtim me Ligjin për RTK-në, neni 24.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për vula në institucionet e Republikës së Kosovës nr. L – 054

Esat Brajshori - Tha se Projektligji ka kaluar në leximin e parë në Kuvend me 04. 04. 2008 dhe ka marrë lëvdata nga deputetët si një Projektligj i përgatitur mirë. Tani, si Komision funksional, do ta bëjmë amendamentimin e tij. Hap diskutimin.

Gani Buqinca - Tha se nuk kam vërejtje në këtë Projektligj, por nëse dikush ka vërejtje do t'i përkrah.

Fehmi Mujota – Propozoj që megjithatë Projektligji të shqyrtohet nen për nen. Nëse dikush ka vërejtje, në fund ta votojmë atë në tërësi.

Esat Brajshori – E hodhi në votim procedurën e kalimit të ligjit nen për nen, por ky propozim nuk u përkrah nga anëtarët e Komisionit.

Melihate Tërmkoll - Propozoi që Komisioni ta formojë një grup pune që më hollësisht do të merrej me shqyrtimin e Projektligjit.

Esat Brajshori – Tha, pasi Projektligji në seancë ka marrë përkrahje nga të gjitha grupet parlamentare, kësaj radhe mund të shkojmë vetëm me propozime konkrete pa formuar grup pune.

Hajdin Abazi - Tha se kam vërejtje për mospërputhje ndërmjet gjuhës shqipe, serbe dhe angleze për shumë terma. Gjithashtu vetë ligji flet për vulat, ndërsa disa nene flasin në njëjës vetëm për vulën, që do të thotë lihet përshtypja se ka vetëm një vulë të rrumbullakët, ndërsa ka edhe një vulë katrore, pra të harmonizohen këto çështje. Të shtohet një nen, ku do të thuhet se vulat e institucioneve janë dy: e rrumbullakëta dhe katrorja.

Fehmi Mujota - Tha se ia kemi dhënë vizën këtij ligji edhe para leximit të parë, por sot nuk i kemi sjellë vërejtjet konkrete, prandaj propozoj që ligji të shqyrtohet në një mbledhje tjetër.

Anëtarët e Komisioni u pajtuan që ky Projektligj të shqyrtohet në mbledhjen e radhës.

4. Të ndryshme.

Esat Brajshori - Propozoj që pas shqyrtimit të ligjit Komisioni të dalë edhe në terren dhe ta shikojë edhe zbatimin e ligjeve.

Hajdin Abazi - Propozoi të ftohet ministri i Ministrisë së Shërbimeve Publike të sqarojë pse në anglisht është “... Kosovo”, kurse në shqip “... Kosova” dhe të na sqarojë se a mund ta ndryshojmë këtë në anglisht.

Gani Buqinca - Tha se pas 15 qershorit do të hyjë në fuqi Kushtetuta e Kosovës dhe pastaj gjuha angleze nuk do të jetë më gjuhë zyrtare në Kosovë.

Kryetari e përmbylli mbledhjen me propozimin që mbledhja e radhës të mbahet të premten në orën 13: 00.

Përgatitur nga
Zyrtarët e Komisionit

Kryetari i Komisioni

Esat Brajshori